

Titulli i lëndës: HISTORIA E ARKITEKTURES - ANTIKA

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Arkitektures Programi studimor – BSc Arkitekture
Titulli i lëndës:	HISTORIA E ARKITEKTURES - ANTIKA
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I-re (Sem-2)
Numri i orëve në javë:	2+1
Kreditë ECTS:	4
Koha / Vendi:	Sipas orarit te shpallur
Mësimdhënësi:	Prof.Asoc.Dr. Teuta Jashari Kajtazi
Të dhënat kontaktuese:	teuta.kajtazi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Historia e Arkitekturës në përgjithësi nënkupton të dhënat mbi zhvillimet në arkitekturë të cilat janë në plotësim të vazhdueshëm. Historia e Arkitekturës - Antika është pjesë e historisë e cila nënkupton të dhënat mbi Arkitekturën e Shekullit të vjetër duke filluar nga Parahistoria e deri tek zhvillimet në kuadër të Romës klasike. Po ashtu përfshihet edhe Arkitektura antike në trojet shqiptare.
Qëllimet e lëndës:	Ka për qëllim njohjen e formave arkitekturore që nga fillimi i njerëzimit duke vazhduar më pas me format e thjeshta të përsëritshme në Egjipt, Mezopotami dhe Persi, dhe duke arritur kështu deri te format e zhvilluara të tempujve në Greqi dhe tek tipologjia komplekse e Romës, si dhe arkitektura në trojet shqiptare e cila i takon Shekullit të vjetër.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Padyshim do të kuptohet se njerëzimi është ai i cili e zhvilloi arkitekturën (shkencën dhe artin e ndërtimit) duke arritur poashtu të kuptohet magjia e shëndërrimit apo kalimit nga një kasolle e thjeshtë deri te veprat e vërteta të artit dhe arkitekturës. Studentët ndër të tjera do të fitojnë njohuri më të thella mbi orderet apo rendet stilike në arkitekturën e klasike, si dhe do të shohin lidhshmërinë e arkitekturës me kushtet e përgjithshme historike.

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	1	15	15
Punë praktike	-	-	-
Përgatitje për test intermediar	1	3	3
Konsultime me mësimdhënësin	0.5	14	7
Puna në terren	-	-	-
Testi, punimi seminarik	1	5	5
Detyrë shtëpie	2	5	10
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	5	5
Përgatitja për provimin final	1	5	5
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	5	2	10
Projektet, prezantimet, etj.	2	5	10
Shto ndonjë aktivitet tjetër që nuk është në tabelë...	-	-	-
Total			100
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata/ Leksione teorike Ligjerata praktike/ ushtrime – Do të kenë në përmbajtje: - Punim individual semestral/ Albumin e skicave/punimeve, i cili ne menyre vizuele do te i percjelle ligjeratat teorike. Cdo periudhe kohore apo arkitekture do te prezentohet me me se paku tri skica/punime.		

<p>Metodat e vlerësimit:</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Detyra semestrare gjeneron 50% të totalit (përfshirë vijimin e rregullt dhe aktivitetin) - Prezentimi i përgatitur lidhur me periudhat e ligjeruara (deri në tre pjesëmarrës në grup të prezentimit) gjeneron 5% të totalit - Testi intermediar gjeneron 20%, derisa Testi final 25% të totalit. (Provimi final 45%, për dy afate të njëpasnjëshme) <u>Totali 100%</u> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja në teste semestrare është e obligueshme. - Aplikohet vlerësimi i vazhdueshëm me përmbajtje/përqindje të aktiviteteve si me sipër. - Në fund të semestrit bëhet konfirmimi i notes/vlerësimit të arritur, të cilin studenti mund ta pranojë apo refuzojë (në SEMS). - Me rastin e refuzimit të notes/vlerësimit semestral, apo mospërfundimit të gjatë të komponentave të vlerësimit të vazhdueshëm gjatë semestrit, studenti i nënshtrohet provimit final siç është e specifikuar në Rregulloren e përgjithshme për sistemin e vlerësimit, që thekson se: "Studenti i cili nuk është i kënaqur me notën përfundimtare, mund të kërkon rivlerësim, duke iu nënshtuar provimit final (45%) edhe në dy afate vijuese të njëpasnjëshme" (Qershor dhe Shtator në rastin konkret). Duke nënkuptuar se pikët e vlerësimit të vazhdueshëm ruhen edhe në dy afate të tjera të njëpasnjëshme të provimeve! Pas këtyre afateve vlerësimi i vetëm do të jetë nëpërmes pikëve të arritura në provim, por që nuk mund të jetë vlerësim maksimal!
<p>Literatura primare:</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Teuta Jashari-Kajtazi, <i>Ligjeratat dhe Prezentimet</i> (te cilat do të publikohen në SEMS pas çdo njesie të ligjeruar) - Architecture: The Definitive Visual History; <i>Dr. Barnabas Calder, 2023</i> - A Global History of Architecture; <i>Francis D.K. Ching, Mark Jarzombek, Vikramaditya Prakash, 2010</i> - A World History of Architecture; <i>Michael Fazio, Marian Moffet, Lawrence Wodehouse, 2003</i>
<p>Literatura shtesë:</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Historia e Arkitekturës (The Story of Architecture) – <i>Jonathan Glancey, 2003</i> - Arkitektura – Historia Vizuale/ pamore (Architecture – the visual history) – <i>James Neal, 2017</i> - <i>Artan Krasniqi, Monument (vëllimet 1-3), 2017</i>
<p>Plani mësimor</p>	
<p>Java</p>	<p>Titulli i ligjëratisë</p>
<p>Java 1:</p>	<p>Informimi rreth përmbajtjes e cila do të shtjellohet në kuadrin e lëndës, përfshirë njoftimin me detyrën semestrare</p>

Java 2:	Vendbanimet në Parahistori dhe Ndërtimet Megalite
Java 3:	Zhvillimi i Qyteteve dhe ngritja e Civilizimit
Java 4:	Egjipti i Lashtë – Piramidat dhe Tempujt
Java 5:	Greqia Antike – Rendet stilike/ Orderet dhe Harmonia: Pjesa – 1
Java 6:	<i>Prezentimet e përgatitura nga studentet, nga temat e shtjelluara deri ne Javen e peste</i>
Java 7:	<i>Testi intermediar</i>
Java 8:	Greqia Antike – Rendet stilike/ Orderet dhe Harmonia: Pjesa – 2
Java 9:	Roma Antike – Mjeshterit e ndertimit: Pjesa – 1
Java 10:	Roma Antike – Mjeshterit e ndertimit: Pjesa – 2
Java 11:	Arkitektura antike në trojet shqiptare: Pjesa-1
Java 12:	Arkitektura antike në trojet shqiptare: Pjesa-2
Java 13:	<i>Prezentimet e përgatitura nga studentet, nga temat e shtjelluara prej Javes se tete deri ne te dymbedhjeten</i>
Java 14:	<i>Testi final</i>
Java 15:	<i>Dorezimi i detyres semestrane (26/05/2026)</i>

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

*Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.
Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike, duhet të fikën (apo të vendosen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimi.
Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje dhe ne kontekst me lenden.*